



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr. 7, datë 28.03.2024

PËR

**“MIRATIMIN E DOKUMENTIT PLANI STRATEGJIK I INSPEKTIMIT PËR
SIPËRMARRËSIT E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE”**

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

1.	Z. Tomi	Frashëri	Kryetar
2.	Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
3.	Z. Lorenc	Bako	Anëtar
4.	Z. Bleron	Dokle	Anëtar
5.	Z. Armer	Juka	Anëtar

dhe sekretare e Këshillit Drejtues Znj. Evblina Taçi, në mbledhjen e datës 28.03.2023, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Rregullore e Brendshme e ndryshuar “Për Funkionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postar”, miratuar me Vendimin Nr.18 datë 19.12.2023 të Këshillit Drejtues të AKEP, me propozim të grupit të inspektimit të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“MIRATIMIN E DOKUMENTIT PLANI STRATEGJIK I INSPEKTIMIT PËR
SIPËRMARRËSIT E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE”**

B A Z A L I G J O R E:

1. Neni 132 e vijues i ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (ligji 9918/2008);
2. Neni 46 i ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, (ligji 10433/2011);



AKEP
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Adresa: Rr. “Reshit Çollaku”, Tiranë
Tel.: +355 4 2259 571 Fax: +355 4 2259 106
www.akep.al Email: info@akep.al

3. Ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, (ligji nr. 44/2015);

4. Ligji nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, (ligji 10279/2010);

5. Rregullore nr.46 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, miratuar me Vendim nr. 2695, datë 27.10.2016;

6. Rregullore e Brendshme “Për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.2.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacionin shpjegues mbi çështjen në shqyrtim;
2. Projekt Vendimin e formatuar dhe arsyetuar;

Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N s e:

Dokumenti “Plani Strategjik i Inspektimit për Sipërmarrësit e Komunikimeve Elektronike për vitet 2024-2026”, është hartuar me qëllim, rregullimin e veprimtarisë inspektuese të AKEP sipas Ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Rregullores Nr. 46, datë 27.10.2016 “Metodikë e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”.

Dokumenti i përgatitur përcakton drejtimitet dhe objektivat kryesore të inspektimit në terma afatgjatë (3 vjet) dhe do të përditësohet çdo vit, me qëllim që të sigurohet përshtatja e tij.

Për të garantuar ushtrimin e kompetencës ligjore lidhur me mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me ligjin 9918/2008, i ndryshuar dhe aktet e tjera në zbatim të këtij ligji, veçanërisht të zbatimit të kushteve të përgjithshme të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm si dhe të përdorimit të frekuencave dhe numeracionit në përputhje me kushtet e përcaktuara në Autorizimet Individuale, AKEP-i kryen në mënyrë të vazhdueshme inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve dhe monitorimin e përdorimit të spektrit prej tyre.

Dokumenti “Plani Strategjik i Inspektimit për Sipërmarrësit e Komunikimeve Elektronike për vitet 2024-2026”, i propozuar nga grupi i punës është i drejtë, i bazuar ligjërisht dhe në përputhje me

2

synimet dhe funksionet e AKEP për përmbushjen e objektivave rregullatore të përcaktuara në ligjin nr. 9918/2008, i ndryshuar.

Praktika dokumentare për shqyrtim të çështjes sipas objektit është paraqitur nga Grupi i Punës në përputhje me kërkesat procedurale të përcaktuara në nenin 12 të Rregullores së Brendshme të AKEP.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Pasi e gjen dokumentin në përputhje me kërkesat ligjore në mbështetje të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Rregullores Nr. 46, datë 27.10.2016 "Metodikë e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike" dhe bazës ligjore sipërcituar,

V E N D O S:

1. Të miratojë dokumentin "Plani Strategjik i Inspektimit për Sipërmarrësit e Komunikimeve Elektronike për vitet 2024-2026".
2. Ky Vendim dhe "Plani Strategjik i Inspektimit për Sipërmarrësit e Komunikimeve Elektronike për vitet 2024-2026" të publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Tomi Frashëri



Anëtar

Edlira Dvorani

Anëtar

Lorenc Bako

Anëtar

Bleron Dokle

Anëtar

Armer Juka

